

---

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË  
KUFIZUAR  
“TATTOO SUPPLY” SHPK**

---

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME  
PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“TATTOO SUPPLY” SHPK**

**KREU I  
EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1  
EMRI I SHOQËRISE**

1.1 Sot, në Tiranë më datë 01/04/2021, ne te nënshkruarit:

Gentiana Isaku, shtetase Shqiptare, lindur në Tirane, më 19.07.1985, mbajtese e ID me nr. Personal I55719100M,

Melson Isaku, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane, më 17.04.1984 dhe mbajtes i ID me nr. Personal I40417061V,

Themelojnë këtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin

**“TATTOO SUPPLY” Shpk (Me poshte e quajtur “Shoqeria”)**

**NENI 2  
SELIA**

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresen: Tirane,Njesia Bashkiake nr.8,Rruga e Dibres,Pallati Ani Shpk,Kati i pare,Dyqani nr.3

2.2 Ortaket mund të vendosin mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Personat përgjegjes për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

**NENI 3  
KOHEZGJATJA**

3.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit.

**NENI 4  
OBJEKTI I SHOQËRISË**

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqeri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtroje në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:



Tregtimi me pakice dhe shumice, duke perfshire te gjitha aktivitetet e importit, eksportit, aktivitet ndermjetesimi per gamen e materialeve Tattoo. Kryerjen e cdo sherbimi te nevojshem per Tattoo. Per me teper shoqeria mund te veproje si agjent/ndermjetes per kryerjen e aktiviteteve te mesiperme dhe bazuar ne diskpcionin e saj te vetem mund te kontrakoje pale te treta per kryerjen e nje pjese apo te te gjitha sherbimeve te mesiperme. Gjithashtu, Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te saj perfshire edhe aktivitetin e ofrimit te sherbimeve, tregtimin, importimin dhe eksportimin e mallrave. Per te arritur objektin e saj, Shoqeria mund te realizoje drejtperdrejte apo ne menyre te terthorte cdo lloj pjesemarrje ne shoqeri te tjera shiptare apo te huaja, si edhe te hyje ne marredhenie kontraktore, bashkepunimi ose ortakerie me persona te trete, private ose publike, vendas ose 2 te huaj.

4.2 Për më tepër shoqëria mund të veproje si agjent/ndermjetes për kryerjen e aktiviteteve të mësipërme dhe bazuar në diskpcionin e saj të vetem mund të kontrakoje palë të treta për kryerjen e një pjese apo të të gjitha sherbimeve te mesiperme.

4.3 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryeje çdo aktivitet tjeter të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qellimeve të saj përfshirë edhe aktivitetin e ofrimit te sherbimeve, tregtimin, importimin dhe eksportimin e mallrave.

4.4 Për të arritur objektin e saj, Shoqëria mund të realizoje drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë cdo lloj pjesemarrje në shoqeri të tjera shiptare apo të huaja, si edhe të hyje ne marredhenie kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë, privatë ose publike, vendas ose te huaj.

## KREU II KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE

### NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË

5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100,000 Lekë, i përbërë nga 2 (dy) kuota, të ndara si më poshtë:

Gentiana Isaku, person fizik, zoteruese e 1 (nje) kuote me 50% (pesedhjetëperqind) dhe vlerë 50,000 lekë.

Melson Isaku, person fizik, zoterues i 1 (nje) kuote me 50% (pesedhjetëperqind) dhe vlerë 50,000 lekë.

Derdhja e kapitalit do te kryhet pas regjistrimit te Shoqerise ne regjistrin tregtar, gjate fazes se zhvillimit te aktiviteti te Shoqerise.

### NENI 6 TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETËT

6.1 Transferimi i kuotave te kapitalit te Shoqerise mund te behet me shitje, trashegimi, ose me çdo menyre tjeter te parashikuar nga ligji.

6.2 Ne rast transferimi te kuotave tek persona te trete jashte Shoqerise, qofte me shitje qofte me dhurim, ortaku qe synon te transferoje kuotat duhet t'i komunikoje ortakeve te tjere vullnetin e tij me shkrim.. Ortaket e tjere kane te drejten e parablerjes te kuotave te ortakeve, me kushte te barabarta, dhe duhet ta ushtrojne kete te drejte brenda 30 diteve nga marrja e komunikimit te vullnetit te ortakut per te transferuar kuotat.

6.3 Vlera e kuotes qe transferohet do te percaktohet nga nje ekspert i emeruar nga ortaket me marreveshje ose nga gjykata ne rast se ortaket nuk bien dakort.

**NENI 7  
BARRA MBI KUOTAT E KAPITALIT**

7.1 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rëndohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale

**KREU III  
ORTAKET E SHOQERISE, FINANCIMET**

**NENI 8  
ORTAKET**

8.1 Ortaket e shoqerise jane:

Gentiana Isaku, shtetase Shqiptare, lindur në Tirane, më 19.07.1985, mbajtese e ID me nr. Personal I55719100M,

Melson Isaku, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane, më 17.04.1984 dhe mbajtes i ID me nr. Personal I40417061V,

**NENI 9  
ORGANET E SHOQERISE**

9.1 Organet e Shoqerise jane:

- a) Asambleja e Pergjithshme;
- b) Administratoret.

**Neni 10**  
**ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

10.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise dhe merr vendime kur eshte mbledhur rregullisht.

10.2 Vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme, e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, ne perputhje me ligjin dhe me kete Statut jane te detyrueshme per te gjithe ortaket perfshire ata qe mungojne.

10.3 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne rastet e parashikuara nga ky Statut, nga ligji per shoqerite tregtare, ligje te tjera, dhe sa here eshte e nevojshme per mbrojtjen e interesave te Shoqerise.

10.4 Asambleja e Pergjithshme mbahet ne seline e Shoqerise ose ne çdo vend tjeter te shenuar ne njoftimin per mbledhje. Njoftimi per mbledhje i dergohet me shkrim te gjithe ortakeve jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se mbledhjes. Njoftimi duhet te permbate vendin, daten, oren dhe rendin e dites se mbledhjes.

10.5 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nga administratoret. Thirrja e Asamblese se Pergjithshme mund te kerkohet edhe nga ortaku ose ortaket qe perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne Asamblene e Pergjithshme.

10.6 Asambleja e Pergjithshme thirret ne sesione te zakonshme e jashtezakonshme.

**Neni 11**  
**ASAMBLEJA E ZAKONSHME**

11.1 Asambleja e zakonshme mblidhet, çdo vit brenda gjashte muajve nga data e mbylljes se vitit finanziar, per miratimin e raportit te administratoreve, inventareve dhe llogarive vjetore.

11.2 Vendimet merren me shumice te zakonshme te votave ne prani te ortakeve me te drejte vote qe zoterojne me shume se 50 % te kuotave.

11.3 Nese nuk arrihet kuorumi sipas pikes 11.2, Asambleja do te mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njejtin rend dite. Ne rast se as ne mbledhjen e dyte nuk arrihet kuorumi, ortaket e pranishem ose rregullisht te perfaqesuar do te perbejne kuorumin.

**Neni 12**  
**ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME**

12.1 Asambleja e Pergjithshme thirret ne sesione te jashtezakonshme sa here eshte e nevojshme per marrjen e vendimeve ne interes te Shoqerise.

12.2 Vendimet qe kane te bejne me (por pa u kufizuar vetem ne to): ndryshimin e neneve te Statutit, zmadhimin ose zvogelin e kapitalit, ndryshimin thelbesor te objektit te veprimitarise se Shoqerise, prishjen e Shoqerise konsiderohen vendime te jashtezakonshme.

12.3 Vendimet e jashtezakonshme merren nga Asambleja e Pergjithshme me  $\frac{3}{4}$  e votave ne prani te ortakeve qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave.

12.4 Nese nuk arrihet kuorumi sipas pikes 12.3, Asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njejin rend dite. Ne rast se ne mbledhjen e dyte nuk arrihet kuorumi, ortaket e pranishem ose rregullisht te perfaquesuar do te perbejne kuorumin.

### **Neni 13 Pjesemarrja, Votimi dhe Perfaqesimi**

13.1 Secili ortak ka te drejten e pjesemarrjes dhe votimit ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme. Votat e disponuara nga secili ortak jane ne numer te barabarte me kuotat e zoteruara prej tij.

13.2 Secili ortak mund te perfaqesojet ne mbledhjet e Asamblese nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete me autorizim. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njetin rend dite.

### **Neni 14 Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme**

14.1 Asambleja e Pergjithshme vendos per:

- a) percaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshimin e Statutit;
- c) emerimin dhe shkarkimin e anetareve te Keshillit te Administrimit dhe caktimin e shperblimit te tij/tyre;
- d) emerimin dhe shkarkimin e likuidatori/eve dhe eksperteve kontabel te autorizuar dhe shperblimin e tyre;
- e) mbikyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurise se veprimtarise;
- g) miratimin e zmadhimit dhe zvogelimit te kapitalit te Shoqerise;
- h) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/eve;
- j) shperndarjen e fitimeve;
- k) riorganzimin dhe prishjen e Shoqerise;
- l) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te Asamblese;
- m) çeshtje tjeter te caktuar nga ligji ose nga ky Statut.

n) Kërkesa për kredi bankare dhe / ose nënshkrimit të faturave, garanci ose garanci në favor të palëve të treta

**NENI 15**  
**FINANCIMI I SHOQËRISË**

15.1 Organi i Administrimit te Shoqërisë në përputhje me dispozitat në fuqi përvec rasteve të zmadhimit te kapitalit ka të drejtë të kërkoje nga ortaket e Shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë

15.2 Financimet e mëtejshme të ortakeve në shoqeri do të jene me shperblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të levrohen këto fonde.

**KREU IV**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

**NENI 16**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

16.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator ;

- Gentiana Isaku, shtetase Shqiptare, lindur në Tirane, më 19.07.1985, mbajtese e ID me nr. Personal I55719100M,

i cili emerohet nga ortaket e shoqerise për një periudhë 5 vjecare me të drejtë rizgjedhje.

Administratori shkarkohet nga detyra, ne çdo kohe, me vendim te zakonshem te Asamblese se Pergjithshme sipas Statutit te Shoqerise.

Administratori ka kompetencat dhe detyrat e meposhtme:

- a) mbikeqyr dhe zbaton politiken e biznesit te Shoqerise;
- b) perfaqeson Shoqerine;
- c) kujdeset qe Shoqeria te zbatoje ligjet dhe standartet e mbajtjes se llogarive;
- d) pergatit dhe nenshkruan bilancin dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve ja paraqet Asamblese se Pergjithshme per miratim;
- e) siguron qe deklaratat e llogarive vjetore si dhe rapporti i ecurise se biznesit dhe çdo deklarim tjeter i detyrueshem sipas statutit, jane bere siç duhet;
- f) siguron qe auditimi i librave dhe i te dhene kryhet te pakten një here ne vit nga eksperte kontabel te certifikuar dhe rapporti i llogaritareve publike te certifikuar t'i vihet ne dispozicion Asamblese se Pergjithshme;
- g) krijon një sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqerise;



16.2 Administratori mund te ndërmarrë apo të kërkoj kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë pervec atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakeve apo organeve të tjera të Shoqërisë.

**NENI 17  
SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT**

17.1 Shpërbimi i administratorit të shoqërisë do të percaktohet nga Ortaket

**KREU V  
KONTROLLI KONTABËL I SHOQËRISË  
VITI FINANCIAR DHE BILANCI  
NENI 18  
KONTROLLI KONTABËL**

18.1 Kontrolli i jashtem kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspert Kontabel të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Ortaket do të emerojne një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kërcohët në baze të ligjit.

**NENI 19  
VITI FINANCIAR**

19.1 Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të cdo viti

**NENI 20  
BILANCI DHE REZERVAT**

20.1 Me mbylljen e secilit vit finanziar Administratoret marrin masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin finanziar të mbyllur ne mënyrë që ortaket të vendosin mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme te tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.

20.2 Ortaket vendosin mbi ndarjen e dividenteve që rezultojne si fitime sipas bilancit te miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma janë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.

20.3 Ortaket në cdo moment mund të vendosin krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

**KREU VI  
PRISHJA DHE NJOFTIMET**

**NENI 21  
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

21.1 Në rastin e likuidimit te Shoqërisë do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin nr. 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

**NENI 22  
NJOFTIMET**

22.1 Të gjitha njoftimet kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nese ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre prane Administratoreve të Shoqërisë.

22.2 Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit per nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.

22.3 Në rastin kur një kuote zotërohet nga më shume se një përson të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqesuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

**KREU VII  
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**NENI 23  
LIGJI I ZBATUESHËM**

23.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt themeli dhe Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë Akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fushën e shoqërive tregtare.

23.2 Ky Akt hartohet ne 3 (Tre) kopje origjinale ne gjuhen Shqipe, dhe pasi lexohet nga Ortaket themelues, firmoset si me poshte prej tyre.

**Gentiana Isaku** Gentiana Isaku 

**Melson Isaku** Melson Isaku 